



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:060726

Datë: 05.09.2023

Numri i dokumentit: 04648871

CP.nr.96/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me zyrtaren ligjore Albulena Latifi, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve: A.M, N.A, A.Z, S.Z, H.M dhe N.S, që të gjithë nga fshati Pataçan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson Av. A.M nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër debitorës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të pagesës së borxhit dhe shpenzimeve gjyqësore në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, në shumë totale prej **12,055.67 euro**, me datë **05.09.2023** merr këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë, Llogaria e Vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar sipas Aktvendimit CP.nr.96/2023, të datës 07.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit përmbarues, Aktgjykimit C.nr.578/2019, të datës 26.05.2021, të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, të bëjë debitimin e mjeteve monetare në shumë prej 9,914.17 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 1,402.50 euro dhe të procedurës përmbarimore shumë prej 739.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej **12,055.67 euro**, në atë mënyrë që nga xhirollogaria bankare e debitorës së përmbarimit Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, t'i bartë këto mjete monetare në dobi të kreditorëve: A.M, N.A, A.Z, S.Z, H.M dhe N.S, që të gjithë nga fshati Pataçan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, në xhirollogarinë e të autorizuarit të tyre, Av. A.M, nga Rahoveci, me **nr. nr... – N**.

II. OBLIGOHET i autorizuari i kreditorëve, Av. A.M, nga Rahoveci dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës – Llogaria e Vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftojnë me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e moszbatimit të tij.

A r s y e t i m

Kreditorët: A.M, N.A, A.Z, S.Z, H.M dhe N.S, që të gjithë nga fshati Pataçan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tyre, Av. A.M nga Rahoveci, në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim për përmbarrim kundër debitorës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të borxhit në emër të shpenzimeve të ushqimit në punë, për periudhën prej datës 18.04.2017 e deri me datë 28.04.2021, në shumat si në vijim:

- Kreditorit A.M, shumën prej 1,312.00 euro;
- Kreditorit N.A, shumën prej 1,312.00 euro;
- Kreditorit A.Z, shumën prej 1,312.00 euro;
- Kreditorit S.Z, shumën prej 1,312.00 euro;
- Kreditorit H.M, shumën prej 1,312.00 euro;
- Kreditorit N.S, shumën prej 1,138.00 euro, e për të gjithë kreditorët shumën e përgjithshme prej 7,698.00 euro dhe për secilin kreditor me kamatë ligjore prej 8%, nga data 16.12.2019 e deri më sot, krejt kjo në bazë të dokumentit përmbarrues, vendimit gjyqësor si në dispozitiv. Shpenzimet e procedurës përmbarrimore i ka kërkuar në shumë prej 739.00 euro.

Kjo gjykatë, me Aktvendimin CP.nr.96/2023, të datës 07.03.2023, e ka lejuar përmbarrimin, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8%, për secilin kreditor, nga data 16.12.2019 e deri me datë 21.07.2023, përmes ekspertizës financiare të datës 21.07.2023, të përpiluar nga eksperti financiar Nevruz Oruqi nga Prishtina. Në këtë kuptim, shuma për të cilën është lejuar përmbarrimi në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për periudhën prej datës 18.04.2017 e deri me datë 28.04.2021, është në shumat si në vijim:

- Për kreditorin A.M, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,689.71 euro;
- Për kreditorin N.A, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,689.71 euro;
- Për kreditorin A.Z, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,689.71 euro;
- Për kreditorin S.Z, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,689.71 euro;
- Për kreditorin H.M, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,689.71 euro;
- Për kreditorin N.S, obligimi, bashkë me kamatë prej 8% arrin vlerën 1,465.62 euro, e për të gjithë kreditorët shuma e përgjithshme prej 9,914.17 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në shumë prej 739.00 euro (në emër të përpilimit të propozimit për përmbarrim shumën prej 468.00 euro, në emër të taksës gjyqësore për propozim shumën prej 21.00 euro dhe në emër të ekspertizës financiare shumën prej 250.00 euro), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,402.50euro, e në vlerën e përgjithshme prej 12,055.67euro.

Pala debitore e ka pranuar vendimin për lejimin e përmbarrimit dhe ekspertizën financiare për llogaritjen e kamatës ligjore, ndërsa në këtë drejtim nuk ka paraqitur prapësim, andaj ky aktvendim është bërë i përmbarrueshëm dhe i formës së prerë. Meqenëse pala kreditore në propozimin për përmbarrim ka cekur mjetin e përmbarrimit, transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare me qëllim të realizimit të detyrimit në të holla, gjykata, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës gjeti se duhet të bëhet debitimi i mjeteve monetare në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë dhe shpenzimeve të procedurës përmbarrimore, përmes xhirollogarisë bankare të potencuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me shikimin në shkresat e lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se pjesa e detyrimit që rrjedh nga dokumenti përmbarrues, Aktgjykimi C.nr.578/2019, i datës 26.05.2021, i nxjerrur nga Gjykata Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, i cili është i plotfuqishëm nga data 19.01.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.03.2023, është përcaktuar saktë shuma e mjeteve monetare që

debitorja i detyrohet kreditorëve, e që përfshin edhe kamatën ligjore prej 8%, për secilin kreditor dhe shpenzimet kontestimore dhe përmbartimore të shkaktuara deri në këtë fazë të procedurës. Kreditorët kanë të drejtën e realizimit të kredisë në të holla, kundër debitorës së përmbartimit, përmes debitimit të mjeteve financiare si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 152 të LPP-së. Gjykata ka gjetur se debitorja obligohet që kreditorëve t'ua kompensojë shpenzimet e ushqimit në punë, shpenzimet kontestimore dhe të procedurës përmbartimore të përshkruara si më lart.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart, kjo gjykatë vendosi që ta urdhërojë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës – Llogaria e Vetme e Thesarit në Prishtinë, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në kuptim të nenit 3, 5 par. 6, nënpar. 2, nenit 13 par. 4, 17, 24 par. 1, 109 par. 3, 113 dhe nenit 152 të LPP-së, e lidhur me nenin 449, 452, 453 dhe nenin 463 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.96/2023, datë 04.09.2023.

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.